



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:182550

Datë: 30.05.2024

Numri i dokumentit: 05756376

2023:182551

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ** - gjyqtari Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani, në çështjen juridike, kontestimore sipas padisë së paditësit F.B. nga Ferizaj, Rr.”....” pnr, të cilin me autorizim e përfaqëson av Besmir Rrahmani nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt – Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, në çështjen juridike pagesa e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, jashtë seancës gjyqësore, më datë 28.05.2024, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

**I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit F.B. nga Ferizaj, si e bazuar.

**II. DETYROHET** e paditura Komuna e Ferizajt - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare në Ferizaj, që paditësit F.B. me numër personal ..., në emër të tri pagave të pa paguara përcjellëse me rastin e pensionimit t’ia paguaj shumën prej 1,777.29€ (Një mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë euro e njëzet e nëntë cent), me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga dita e paraqitjes së padisë 29.08.2023, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 135.00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

### A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 29.08.2023, lidhur me objektin e kontestit kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt - Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare. Në padi, ka theksuar se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në QKMF në Ferizaj dhe se i njëjti ka përvojë pune mbi 33 vite.

Më tej ka theksuar se e paditura ka pasur obligim që me rastin e pensionimit të paditësit t'i bëhet pagesa e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit e paraparë në nenin 17 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë „Kompensimi me rastin e pensionimit, i punësuar me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt e fundit,,.

E paditura përkundër faktit se e ka provuar që çështjen ta zgjidhë në procedurë administrative, por edhe përkundër përpjekjeve të bëra, e paditura asnjëherë nuk ka shfaqur gatishmërinë për të zgjidhur këtë çështje andaj paditësi është detyruar që të paraqes padi në gjykatë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar

E paditura në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit duke propozuar Gjykatës që të njëjtën ta refuzoj si të pabazë. Më tej ka theksuar se paditësi është thirrur në Kontratën Kolektive e cila tani më nuk është në fuqi, kjo ngase ka skaduar afati tri vjeçar i vlefshmërisë së saj.

Tutje ka shtuar se QKMF në asnjë vit fiskal nuk ka pasur mundësi buxhetore për të bërë kompensimin e pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punëtorëve të saj dhe rrjedhimisht nuk ka pasur obligim ligjorë ndaj punëmarrësit në këtë rast. Sa i përket shpërblimit për paga përcjellëse me rastin e pensionimit të punëtorëve të QKMF-s nuk mund të bëjë kompensimin e këtyre kërkesave sepse Qeveria e Republikës së Kosovës pas marrëveshjes ka qenë e obliguar që ta ndajë buxhetin për implementimin e kësaj kontrate dhe në mungesë buxheti për këto pagesa e paditura QKMF nuk ka mundur ta bëjë përmbushjen e këtyre kërkesave.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 398 të LPK-së për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi që nga përgjigja në padi rezulton qartas se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë

pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës kolektive sektoriale e shëndetësisë 11 Qershor 2018 e lidhur ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, ndërsa shuma e kompensimit vërtetohet nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Gjykata pas analizimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqës, konstaton se në mes tyre është kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstaton se në mes të palëve ndërgjyqës nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë fakt e vërtetoi sipas Kontratës së punës dhe listës së pagave të paditësit të bashkangjitura në shkresa të lëndës.

Nga vërtetimi i punësimit Kontrata e punës për kohë të pacaktuar e datës 01.12.2010 e lidhur ndërmjet QKMF-s në Ferizaj dhe paditësit, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka qenë i punësuar si depoist kryesor, me orar të plotë në QKMF në Ferizaj, me pagë n 362€, për një muaj kalendarik të vitit 2010.

Nga vërtetimi i pagës së pranuar nga i punësuar tani paditësi për muajin Tetor 2020, gjykata ka vërtetuar se paditësi ka marrë pagë në muajin e fundit në shumë: 592,43€, për një muaj kalendarik.

Bazuar në provat e bashkangjitura në padi, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale (KKS) 06/2018, për avancimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës dhe respektimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve nënshkruese, i nënshkruar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Kryetari i Federatës së sindikatave të shëndetësisë të Kosovës, ku përcaktohet se: „,Kompensimi me rastin e pensionimit, i punësuar me rastin e pensionimit, gëzon të drejtën në pagesën përcjellëse në lartësi prej tri (3) paga mujore, që i ka marrë për tre (3) muajt e fundit”. Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagat përcjellëse me rastin e pensionimit si është e paraparë me KKS-në.

Nga interpretimi i dispozitave të KKS-së dt. 11.06.2018, të nxjerra nga e paditura dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit sa i përket pagave përcjellëse me rastin e pensionimit është në tersi e bazuar sepse paditësi gëzon të

drejtën që në rastin e daljes në pension, ta përfitoj si shpërblim tri paga në vlerë të tri pagave të marra për tre muajt e fundit sa ka qenë në marrëdhënie pune.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për pagat përcjellëse me rastin e pensionimit, në rastin konkret për paditësin, gjykata mori për bazë vërtetimin e pagës të pranuar të lartshënuar në të cilin shënohet se ka pagë (në vlerë 592.43 euro), e nga e cilat rezulton paga të cilën e ka realizuar paditësi dhe përvojën e punës tek e paditura plotë 33 vite, andaj paditësit ju njoh e drejta në kompensim ashtu siç është në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata, vlerëson se e paditura ka detyrim sipas dispozitave të lartpërmendura, që t'i kompensoj paditësit pagat përcjellëse me rastin e pensionimit pasi duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD-s), në të cilin përcaktohet se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkoj përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë që ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura i ka mbetur borxh paditëses me aplikimin e dispozitave të lartcekura dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shumën e gjykuar si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumat përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 29/08/2023 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe duke pas parasysh edhe faktet jokontestuese nga palët ndërgjyqës në këtë çështje kontestimore, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar sikurse në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që nga provat e paraqitura ka vërtetuar faktin se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura. Lartësia e kërkesëpadisë u mbështet në listën e pagave përmes të cilës u vërtetua shuma se sa është paguar paditësi që është shuma prej 592.43€, andaj kjo ishte baza për llogaritjen e tri pagave (e cila del nga llogaritja e thjeshtë nga paga 592.43 x 3 paga = 1,777.29 euro) andaj edhe këto përllogaritje për gjykatën kanë qenë të sakta dhe reale, ngase vetë kërkesa e paditësit ka qenë e tillë dhe gjykata ka vlerësuar se nuk ka nevojë për nxjerrjen e ekspertizës sipas detyrës zyrtar, për përllogaritjen e të njëjtës.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi sa i përket pjesëve të aprovuara të kërkesë padisë dhe gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendimin se detyrimet financiare nga KKS-ja se nuk prodhojnë efekt për shkak se janë në harmoni me Ligjin mbi ndarjet buxhetore, gjykata vlerëson se këto akte, në këtë rast KKS-ja, janë aprovuar nga struktura të larta të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim respektimin e punëtorëve të cilët kanë kontribuar në punë edhe motivimin e punonjësve për punë kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuara nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit duke u thirrur në mos ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet a po jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat lartcekura, përderisa e paditura me asnjë provë shkresore – analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësi, për pjesën e aprovuar të kërkesës.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e bazoj në dispozitën e nenit 449 dhe 452, të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë në emër të përpilimin të padisë shumën prej 104 euro dhe në emër të taksës gjyqësore në shumën prej 31€ gjithsejtë shumën prej 135 euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

2023:182551, me datë 28.05.2024

**Gjyqtari**  
**Faton Ajvazi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, pas pranimit në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.